



**Amendament i Marreveshjes se Shitblerjes se Kuotave
Nr.1373 Rep dhe Nr.510 Kol me date 31.07.2019**

Ne Tirane, sot me date 29.08.2019 (dymije e nentembedhjete), para meje Noterit Agron T. Bajri, ne zyren time me adrese: Rr."K.K.Mema", P.2, Shk.1, Ap.3, K.1, prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqiten personalisht:

ALEKSANDER FRANGAJ, i biri i Vasilit dhe i Gjystes, lindur me 04.10.1968, banues ne Tirane, me adrese Kompleksi Rolling Hills,Vila nr.87, MULLET, TIRANE i identifikuar me leternmjoftim 029861026,

- I. **Alba Gina**, e bija e Agimit dhe e Aferdites, lindur ne Lushnje, me 14.04.1977, banues ne Tirane, me adrese ne Kompleksi Rolling Hills,Vila nr.87, MULLET, TIRANE e identifikur me leternjoftimin nr. 02986103;

Ne vijim, se bashku referuar si "**Shitesit**",

dhe

A.B.C. Management shpk, nje person juridk shqiptar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me nr. NIPT L91911028V, me seli ne adresen: Rruga Aleksander Moisiu, Ish Kinostudio, Tirane, Shqiperi, me administrator **Znj. Gkouma EFTHIMYA**, shtetase greke, e bija e Vasileios, e datelindjes 30.10.1969, identifikuar nga karta e identitetit me nr. AK 304727, perfaqesuar me prokure te pergjithshme nr. Rep 3476, kol 1525 date 15.07.2019 te noteres Edlira Malaj, nga Z. Arber Karaj, i biri i Ruzhdi dhe Mukades, i datelindjes 05.05.1988, mbajtes i kartes se identitetit nr. I80505081F, banues ne adresen Rr. Kavajes, Pallatet Delijorgji, Tirane, i autorizuar per qellim te kesaj Marreveshje,

Ne vijim referuar si "**Bleresi**",

Te cilet me kerkuan perpilimin e ketij Aneks Kontrate si me poshte vijon:

KUSHTE PARAPRAKE

- A. Palet kane nenshkruar MARREVESHJEN PER SHITBLERJEN E Aksioneve Nr.1373 Rep dhe Nr.510 Kol me date 31.07.2019, prane Notetrit Agron T. Bajri, me objekt , "Shitesit do t'i shesin dhe transferojne Bleresit Aksionet ne Shitje te ABC NEWS sha dhe Bleresi do te bleje dhe perfitoje Aksionet ne Shitje te ABC NEWS sha, per çmimin e percaktuar ne vlere ne Nenin 3, ne perputhje me kushtet dhe modalitetet e percaktuara ne ate Kontrate"

- B. Eshte bere dorezimi i sendit i parashikuar sipas nenit 3 te asaj Marreveshje dhe ne nderkohe Palet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote kane rene dakord qe te ndryshojne disa prej parashikimeve te asaj Marreveshje, duke nenshkruar kete amendament te Marreveshjes si me poshte vijon :

Neni 1.

Neni 2.2 "Koha e kalimit te Pronesise mbi aksionet ne Shitje te ABC News" i Marreveshjes per Shitblerjen e Kuotave do te ndryshohet si me poshte vijon:

2.2. Koha e Kalimit te Pronesise mbi Aksionet ne Shitje te ABC News

Kalimi i pronesise mbi aksionet ne Shitje te "ABC News" sha nga Shitesi te Bleresi do te regjistrohet ne regjistrat publike me nenshkrimin e kesaj kontrate. Ne cdo rast Bleresi do te mbetet i detyruar te zbatoje kushtet e percaktuara ne kete Kontrate dhe plotesoje ne afat detyrimet e treguara ne nenin 3 Cmimin e Blerjes dhe ne nenin 9 Detyrimet e Bleresit.

Neni 2

Neni 3 paragrafi 3.2 "Menyra e pageses per cmimin e Blerjes" i Marreveshjes per Shitblerjen e Aksioneve do te ndryshoje si me poshte :

- 3.2.1 Çmimi i Blerjes ne masen EURO 600,000 (gjashte qind mije) do te paguhet ne 1 kest te vetem ne menyre proporcionale ne llogarite e secilit prej Shitesve si me poshte:

Aksioneri Alba Gina

Numri i llogarise:Raiffeisen Bank

EUR 2000983339

IBAN AL 28202111820000002000983339

ABA Swift: SGSBALTX

Aksioneri Aleksander Frangaj

Numri i llogarise:


EUR 4500000364

IBAN AL06202112710000004500000364

ABA Swift SGSBALTX

- 3.2.2. Shuma prej 300,000 (treqind mije) euro do te paguhet ne llogarine e Aksionerit Alba Gina brenda dates 10 tetor 2019.

Shuma prej 300,000 (treqind mije) euro do te paguhet ne llogarine e Aksionerit Aleksander Frangaj brenda dates 10 tetor 2019.



2

Neni 3

Neni 4 paragrafi 4.2.1 pika 1.1.1 " Kushtet ne daten e nenshkrimit dhe/ose ne daten e dorezimit" i Marreveshjes per Shitblerjen e Kuotave do te ndryshoje si me poshte :

1.1.1 Ne Daten e Nenshkrimit, Shitesit do te:

1. nenshkruajne dhe te dorezojne tek Bleresi, ne çdo forme, çdo dokument tjeter qe mund te kerkohet per regjistrimin e kalimit te pronesis se Aksioneve ne Shitje te ABC News nga Shitesit tek Bleresi, kalimi i cili do te kryhet me nenshkrimin e Marreveshjes se Shitblerjes se Kuotave dhe pas realizimit te dorezimit te sendit.

Neni 4

Neni 5 paragrafi 5.1 "Kalimi i se drejtes se pronesis se aksioneve ne shitje" i Marreveshjes per Shitblerjen e Kuotave do te ndryshoje si me poshte :

- 5.1 Bleresi do te beje regjistrimin e te drejtes se pronesis se Aksioneve ne Shitje, brenda 30 diteve nga data e dorezimit te sendit sic percaktohet ne kete kontrate. Bleresi do te behet pronar i 100 % (njqind perqind) te Aksioneve ne Shitje te Shoqerise ABC News sha dhe lejohet te ushtroje te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga pronesia mbi aksionet ne shitje, me perjashtim te te disa te drejtave te cilat do te mund te ushtrohen vetem me miratimin e Shitesit per periudhen nga dorezimi i sendit e deri kryerjen e pageses teresore te Cmimit te Aksioneve ne Shitje dhe te shlyerjes se Detyrimeve sipas kesaj kontrate te cilat jane te parashikura shprehimisht nenin 2.3.1, 8 dhe 9.2 te kesaj Kontrate.

Neni 5

Neni 9 paragrafi 9.2.3 "Detyrimet e Bleresit" i Marreveshjes per Shitblerjen e Kuotave do te ndryshoje si me poshte :

- 9.2.3 Bleresi merr persiper qe te beje te mundur futjen e kapitalit ne shoqerine ABC news sha qe kjo e fundit brenda nje periudhe prej 30 ditesh nga data e pagimit te Cmimit te Blerjes, te beje pagesat e meposhtme:

Detyrimin e shoqerise ABC news sha ndaj ortakeve Aleksander Frangaj dhe Alba Gina

ne masen 609,600 euro

Pagimin e vleres se pajisjeve te treguara ne pasqyrat financare ne masen 240,000 euro

(perfshire TVSH)

Parapagim per qera ne vleren 294,118 Euro per perdorimin e zyrave per nje periudhe prej 2 vitesh, duke nisur nga data 01.08.2019.



3

Pagim i detyrimeve te prapambetura per qera te shoqerise ABC news sha ne vleren 296,282 euro.

Ne rast se Bleresi deshton te plotesoje ndonje prej detyrimeve te mesiperme, qofte edhe pjeserisht atehere Kontrata do te konsiderohet e zgjidhur me efekt te menjehershem dhe palet do te kthehen ne gjendjen e meparshme duke u detyruar Bleresi te ktheje Aksionet ne Shitje te Shitesit dhe ky i fundit do te mbaje apo do te kete te drejten te kerkoje nje kusht penal ne masen 350,000 (treqind epesedhjetemije) euro. Ne rast se Shitesit deshton te kthje mbrapsht aksionet pas deklarimit te zgjidhjes e kontrates sipas paragrafit te mesiperme, ai do te detyrohet te shperbleje edhe demin per cdo vonese qe mund ti vije Shitesit nga mosplotesimi i detyrimit te kthimit te paleve ne gjendjen e meparshme per shkak te zgjidhjes se kontrates.

Neni 6

Te gjitha kushtet e tjera te parashikuara ne Marreveshjen e Shitblerjes se Kuotave Nr.1373 Rep dhe Nr.510 Kol me date 31.07.2019 mbeten te pandryshaura.

Une, noteri publik pasi ua lexova me ze te larte paleve kete Amendament te Marreveshjes se Shitblerjes se Kuotave Nr.1373 Rep dhe Nr.510 Kol me date 31.07.2019, u sigurova qe ata e gjejne ate konform vullnetit te tyre te lire, vertetoj nenshkrimet e tyre ne perputhje me ligjin.



Shitesit

Znj. Alba Gina

Alba Gina

Z. Aleksander Frangaj

Aleksander Frangaj

Palet

Bleresi

Shoqeria "A.B.C Management" shpk

Administratore Znj. Efthymina Gkouma
Perfaqesuar me prokure nga: Z. Arber Karaj

Arber Karaj



MARREVESHJE PER SHITBLERJE AKSIONESH

DATE 31.07.2019

Mes

Aleksander Frangaj

Alba Gina

Se bashku Shitesit

dhe


A.B.C Management shpk

Bleresi



Pasqyra e Lendes

1	PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET	6
1.1	PERKUFIZIMET.....	6
1.2	INTERPRETIMET.....	8
1.3	KONFLIKTET	10
2	OBJEKTI DHE QELIMI I TRANSAKSIONIT.....	10
2.1	SHITJA DHE BLERJA E AKSIONEVE.....	10
2.2	KOHA E KALIMIT TE PRONESISE MBI AKSIONET NE SHITJE TE ABC NEWS	10
2.3	TRANSFERIMI I AKSIONEVE NE SHITJE TE ABC NEWS SHA	11
3	ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES	11
3.1	ÇMIMI I BLERJES.....	11
3.2	MENYRA E PAGESES PER ÇMIMIN E BLERJES.....	11
4	DATA E NENSHKRIMIT DHE KUSHTET	12
4.1	NENSHKRIMI	12
4.2	KUSHTET NE DATEN E NENSHKRIMIT.....	12
5	KALIMI I SE DREJTES SE PRONESISE SE AKSIONEVE NE SHITJE.....	12
6	KUSHTET PARAPRAKE TE NENSHKRIMIT	13
6.1	KUSHTET PARAPRAKE NEN PERGJEGJESINE E SHITESVE	13
6.2	KUSHTET PARAPRAKE NE PERGJEGJESINE E BLERESIT	13
6.3	ANGAZHIMET PAS NENSHKRIMIT..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.	14
7	DEKLARATAT DHE GARANCITE	14
7.1	DEKLARATAT DHE GARANCITE E BLERESIT	14
7.2	DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESVE.....	15
8	DEMSHPERBLIM I VECANTE	18
8.1	DEMSHPERBLIMI I VECANTE	18
9	PRETENDIME PER DEMET.....	19
9.1	DETYRIMET E SHITESVE.....	19
9.2	DETYRIMET E BLERESIT	19
10	ZGJIDHJA.....	20
10.1	SHKAKU I ZGJIDHJES DHE NJOFTIMI	20
11	LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJET E MOSMARRVESHJEVE	21
11.1	LIGJI I ZBATUESHEM	21
11.2	JURIDIKSIONI	21
11.3	FORCA MADHORE	21
11.4	NJOFTIME	22




11.5	MARREVEESHJA E PLOTE / NDRYSHIMET	22
11.6	KALIMI	22
11.7	EFEKTI DETYRUES	23
11.8	NDASHMERIA.....	23
11.9	MJETE TE TJERA.....	23
11.10	HEQJE DORE.....	23
11.11	KOSTOT DHE TAKSAT.....	23
11.12	KONFIDENCIALITETI.....	23
11.13	GJUHA DHE KOPJET	24



LISTA E ANEKSEVE

- ANEKSI 1: Informacioni i Dhene, lista e dokumentave te nevojshme per tu paraqitur te AMA dhe lista e punonjesve dhe bashkepunetoreve qe bejne programe
- ANEKSI 2: Pasuria e paluajtshme qe do te jete objekt i qerases afatgjate
- ANEKSI 3: Inventari
- ANEKSI 4: Pasqyrat Financiare
- ANEKSI 5: Gjendja e detyrimeve per te tretet e shoqerise deri ne 31 Korrik 2019.
- ANEKSI 6: Autorizimet e Bleresit dhe te Shitesve

--



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 1373 REP.

NR. 510/
14 KOL.

Taksa e Pullës
U Pagua



MARREVESHJE PER SHITBLERJEN E KUOTAVE

Në Tiranë, sot më datë 31.07.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje Noterit Agron T. Bajri, në zyrën time me adresë: Rr. "K.K.Mema", P.2, Shk.1, Ap.3, K.1, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u paraqitën personalisht:

- I. **Z. ALEKSANDER FRANGAJ**, i biri i Vasilit dhe i Gjystes, lindur me 04.10.1968, banues ne Tirane, me adrese Kompleksi Rolling Hills,Vila nr.87, MULLET, TIRANE i identifikuar me leternmjoftim 029861026,
- II. **Znj. Alba Gina**, e bija e Agimit dhe e Aferdites, lindur ne Lushnje, me 14.04.1977, banues ne Tirane, me adrese ne Kompleksi Rolling Hills,Vila nr.87, MULLET, TIRANE e identifikur me leternjoftimin nr. 02986103;

Ne vijim, se bashku referuar si "Shitesit",

dhe

Shoqeria "A.B.C. Management" shpk, nje person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT L91911028V, me seli në adresën: Rruga Aleksander Moisiu, Ish Kinostudio, Tiranë, Shqipëri, me administrator **Znj. Gkouma EFTHIMYA**, shtetase greke, e bija e Vasileios, e datëlindjes 30.10.1969, identifikuar nga karta e identitetit me nr. AK 304727, perfaqesuar me prokure te pergjithshme nr. Rep 3476, kol 1525 date 15.07.2019 te noteres Edlira Malaj, nga Z. Arber Karaj, i biri i Ruzhdi dhe Mukades, i datelindjes 05.05.1988, mbajtes i kartes se identitetit nr. I80505081F, banues ne adresen Rr. Kavajes, Pallatet Delijorgji, Tirane, i autorizuar per qellim te kesaj Marreveshje,

Ne vijim referuar si "Bleresi",

Shitesit dhe Bleresi jane te referuar ne menyre individuale ne vijim si "Pale" dhe se bashku referuar si "Palet" te tere madhore dhe me pergjegjesi juridike dhe per te vepruar per identitetin e te cileve une noteri jam personalisht i bindur.

HYRJE:

- (A) Shitesit jane ortake te shoqerise ABC News sha. (ABC NEWS SHA), nje shoqeri anonime, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit me numer unik biznesi (NIPT) K01711004F, me adrese: Tirane, Rruga Aleksander Moisiu, ish Kinostudio, Tirane, me kapital te barabarte me 70.000.000 LEK (shtatedhjetë milion).

- (B) Bleresi u ka dorezuar Shitesve nje oferte jo detyruese, duke shfaqur mes te tjerash interesin e tij per te blere 100% te kuotave te kapitalit te ABC News sha.
- (C) Ne vazhdim te shprehjes se interesit te Shitesve per te shitur 100% te aksioneve te Bleresi, Shitesi pergatiti pasqyrat financiare te shoqerise te cilat paraqesin te tere situaten financiare te shoqerise duke paraqitur edhe listen teresore te detyrimeve te pagueshme deri ne daten 31.07.2019.
- (D) Aksionet e ABC News sha jane te zoteruara nga aksioneret e meposhtem:
- i. **Alba Gina zoteron 50% te aksioneve te shoqerise me nje vlere kapitali prej 35.000.000 lek;**
 - ii. **Aleksander Frangaj 50% te aksioneve te shoqerise me nje vlere kapitali prej 35.000.000 lek**
- (E) Shitesit kane shprehur vullnetin e tyre per te shitur dhe Bleresi shpreh vullnetin per ta blere nga Shitesit 100 perqind te aksioneve te shoqerise ne perputhje me kushtet dhe detyrimet e kesaj Kontrate.
- (F) Organet vendimmarrese te Bleresit miratuan blerjen e 100 %te aksioneve te ABC news Sha sipas kushteve dhe detyrimeve te percaktuara ne kete Kontrate dhe kane miratuar autorizimin/et perkates/e per nenshkrimin e kesaj Marreveshje, te perfshira ketu si Aneksi 6 (Autorizimet e Bleresit dhe te Shitesve);

Mbi bazen e kushteve paraprake te mesiperme palet lidhin kete Kontrate per shitblerjen e aksioneve, si me poshte:

1 PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

1.1 Perkufizimet

Pervec rasteve kur kjo Kontrate kerkon ose referon ne terma te ndryshem dhe ne vazhdim te kushteve te percaktuara ne vende te tjera te kesaj Marreveshje (duke perfshire Hyrjen dhe Anekset bashkengjitur), fjalet do te mbartin keto kuptime:

"ABC News"	ka kuptimin e percaktuar ne piken A te Kushteve paraprake;
"Aksionet ne Shitje"	Ka kuptimin te parashikuar ne piken E te Kushteve paraprake;
"Marreveshje/Kontrate"	nenkupton kete kontrate shitblerje aksionesh duke perfshire anekset bashkengjitur dhe kushtet paraprake;
"Autorizim"	nenkupton autorizimet, lejet, licencat, miratimet, deklaratat, autorizimi i kerkuar nga Bleresi ose shoqeria ne menyre qe te kryeje transakcionin ne aktivitetet perkatese te biznesit;
"Çmimi i Aksioneve ne Shitje te ABC News"	nenkupton vleren totale te 600,000 euro (gjashteqind mije) Euro duke perfshire taksat e zbatueshme;

"Dite Pune"

nenkupton çdo dite kalendarike e ndryshme nga e shtuna dhe e diela dhe çdo dite tjeter ne te cilen bankat nuk punojne ne Tirane, (Shqiperi);

"Informacion i Dhene"

nenkupton mbledhjen e dokumenteve, materialeve, dhe informacion i bere i disponueshem per Bleresin, dhe i gjithë informacioni i dorezuar me ane te emailit ose ne ndonje menyre tjeter ne forme te shkruar, gjate negociatave deri ne Daten e Nenshkrimit dhe Dorezimit;

"Deklarimet Financiare te Shitesit"

ka kuptim te dhene ne piken (C) te Hyrjes;

"Inventari"

nenkupton listen e mjeteve, sendeve dhe gjerave te ngjashme me to, te detajuara ne Aneksin 3;

"Force Madhore"

nenkupton çdo urdher, rregullore ose udhezim te qeverise, qofte ne formen e nje ligji ose ndryshe, ose çdo sanksion me natyre kombetare ose nderkombetare, kryengritje, trazira, shqetesime civile, lufte (e deklaruar ose e padeklaruar) akte ose kercenime nga terroriste, grupe guerile apo individe te ketyre grupeve, zjarri, permytje, termet, sulme, bllokade apo çdo lloj ndodhie e shkaktuar pa faj ose neglizhence te Paleve, ose secilit prej tyre, te cilat mund te jene ose jo te ngjashme me sa permendur me lart, me kusht qe kjo ngjarje te jete pertej kontrollit te arsyeshem te Pales se prekur;

"Autoritet Shteteror"

nenkupton çdo gjykate apo autoritet gjyqesor ose qeveritar, administrativ ose organ rregullator, Department, agjenci, komision, autoritet;

"Detyrime"

nenkupton vleren totale te detyrimeve prej 1,440,000 Eur te cilat i jane paraqitur Bleresit nga ana e shitesit deri ne daten 31.07.2019, date e dorezimit te Shoqerise (si percaktohet ne Aneksin 4) e cila do te paguhet sipas percaktimeve te kesaj Marreveshje nga ana e Bleresit;

"Humbje" ose "Humbjet"

nenkupton çdo demtim (duke perfshire demin aktual te shkaktuar dhe fitimin e munguar, demin direkt dhe indirekt, ne cilendo shtate te parashikuar apo jo), duke perfshire kostot dhe shpenzimet (duke perfshire tarifat ligjore apo gjyqesore), humbje ose pergjegjesi;

"Garancite e Shitesve"

nenkupton perfaqesimet dhe garancite e Shitesve te rregulluara ne nenin 7.2 te Kontrates



"Data e Nenshkrimit"

nenkupton daten kur Marreveshja eshte e nenshkruar rregullisht nga te gjitha Palet;

"Data e Dorezimit"

nenkupton daten kur Kompania i dorezohet Bleresit pasi Marreveshja eshte e nenshkruar rregullisht nga te gjitha Palet dhe jo me heret se pas mbylljes se muajit kalendarik Korrik 2019 qe eshte data 1.8.2019.

"Autoriteti Tatimor"

nenkupton çdo autoritet tatimor ose autoritet shteteror kompetent per te vendosur çdo detyrim tatimor, apo pergjegjes per administrimin dhe/apo mbledhjen e taksave, ose zbatimi e ndonje legjislacionit fiskal;

"Taksa"

nenkupton te gjitha taksat (perfshire TVSH dhe taksen e transferimit), tatimet, detyrimet (doganore ose ndryshe), importet detyrimet dhe tatimet ne burim te çfaredolloj natyre, duke perfshire (pa asnje limit) taksat mbi te ardhurat bruto dhe neto, kontributet e sigurimeve shoqerore, fitimet ose te ardhura dhe taksat ne faturime, shitje, perdorim, profesion, franchising, TVSH dhe taksa mbi pronen, se bashku me te gjitha gjobat, detyrimet dhe interesat ne lidhje me secilen prej tyre;

"Dokumentet e Transaksionit "

nenkupton kete Kontrate dhe çdo dokument te paraqitur ose shperndare ne perputhje me secilin prej tyre pas Dates se Nenshkrimit;

"Transaksioni"

nenkupton shitjen dhe blerjen e 100 te aksionve qe Shitesit zoterojne dhe kane ne pronesi ne shoqerine ABC news Sha nga Shitesit te Bleresi, parashikuar ne kete Kontrate.

1.2 Interpretimet

Ne kete Marreveshje (duke perfshire pershkrimin dhe anekset), perveç nese kerkohet ndryshe ose nese eshte specifikuar ndryshe ne vijim:

- Gjinia mashkullore do te perfshije gjinine femerore dhe gjinine asnjane dhe numri njejes do te perfshije numrin shumes dhe anasjelltas;
- Referimet ne marreveshje ne nen dhe ankese, jane nene dhe ankese te kesaj Marreveshje (vetem nese konteksti kerkon ndryshe);
- Titujt jane te perfshire vetem per lehtësi dhe nuk mbartin efekt interpretimi te kesaj Marreveshje;
- Perveç rasteve kur eshte e perfshire ne menyre eksplicite, çdo dispozite e kesaj Marreveshje e cila eshte detyruese per me shume se nje person, perveç rasteve kur konteksti parashikon ndryshe, do te detyroje ne menyre te ndare apo te bashkuar secilin prej tyre;

- Referimet mbi procesin e shkrirjes se nje personi perfshin perzierjen, shperberjen, falimentimin, likuidimin, ose bashkimin e atij personi me çdo person tjetër ekuivalent ose çdo veprim tjetër analog ne baze te se cilit ky person eshte i regjistruar, ka vendbanim, eshte rezident, operon biznesin ose ka asete.
- Çdo referim ne libra, regjistrim ose informacion ndryshe nenkupton librat, regjistrim apo çdo informacion tjetër te çfaredolloj forme perfshire materiale ne leter, menyre elektronike apo vendosja ne CD (magneti media), filmime dhe mikrofilma.
- Nje referim ne çdo ligj, rregullore, statut apo ne dispozita te tjera statutore do te interpretohet si nje referim tek akti ne fjale, si ky mund te ndryshohet, modifikohet ose rimiratohet kohe pas kohe;
- Nje referim ne çdo marreveshje do te perfshije çdo ndryshim, modifikim dhe shtese apo shfuqizim, te cilat mund te hyjne ne fuqi ne çdo moment, perveç rasteve kur parashikohet ndryshe;
- Referencat ne çdo dokument te miratuara **"sipas formes se rene dakord"** jane dokumentet ne formen dhe me brendi te rene dakord nga Palet, dhe sigluar nga ose per Palet per identifikim;
- Referimet te **"nje person i trete"** apo **"pale e trete"** do te interpretohen duke perfshire çdo person te ndryshem nga palet e kesaj Marreveshje;
- Nje shoqeri eshte e kontrolluar nga nje tjetër (**"personi kontrollues"** i tij) ne qofte se personi tjetër, ne menyre direkte apo indirekte, nepermjet nje ose disa shoqerive te kontrolluara ose personat e tjere kontrollues:
 - o Ka ne pronesi shumicen e interesit pasuror ose te se drejtes se votes ne te;
 - o Eshte anetar apo ortak i saj, dhe ka te drejten per te emeruar apo shkarkuar shumicen e drejtove, bordit drejtues ose te nje organi tjetër ekuivalent;
 - o Eshte nje anetar ose ortak i saj dhe ka kontroll te plote, ose ne mbeshtetje te nje marreveshje me ortakët ose anetaret e tjere, ka shumicen e interesit ose te drejtes se votes ne te.
 - o Ka te drejten ose mund te ushtroje faktikisht nje influence mbi ate te drejte, per shembull (i) duke patur te drejten ose duke patur mundesine te jape udhezime ne lidhje me politikat financiare apo operative, me te cilat drejtoret jane te detyruar ta zbatojne apo do te pajtohen me to, (ii) nepermjet parashikimeve ne dispozitat e memorandumit ose statutit te shoqerise apo akteve te shoqerise, (iii) nepermjet nje kontrate kontrolli se marreveshje ortakësh; ose
 - o Ka nje interes pjese-marres ne te dhe ose ushtron nje influence kontrolli mbi te ose te dy shoqerite drejtohen ne menyre te unifikuar;

Dhe perkufizimet **"shoqeri te kontrolluara"** dhe **"personat kontrollues"** duhet te interpretohen ne perputhje me to.

- Nje detyrim i nje Pale per te **"siguruar"** nje veprim, mundesi ose tolerim per nje veprim nga nje person i trete do te nenkuptoje nje detyrim ne perfundim dhe nje premtim detyrues e asaj Pale per aktin, mundesine apo tolerimin e specifikuar ne lidhje me personin e trete;






- Per te llogaritur kohen per kryerjen e veprimit ose ndermarrjen e nje hapi per kryerjen e tij, data e cila do te merret si reference ne momentin e llogaritjes, ajo periudhe do te hiqet dhe nese ajo dite nuk eshte nje Dite Pune, afati do te perfundoje ne ditën pasardhese qe eshte Dite Pune;
- Çdo material bashkangjitur kesaj Marreveshje duke perfshire Anekset perben nje pjese integrale te kesaj Marreveshje dhe çdo reference ne kete Marreveshje do te thote reference edhe ne materialet bashkangjitur, ne formen e aneksit apo ndonje forme tjeter. Gjithsesi Palet bien dakord kushtet tregtare dhe ligjore te percaktuara ne kete Marreveshje do te kene perparesi kundrejt kushteve te ngjashme te percaktuar ne Anekse; dhe
- Nje reference tek nje Pale do te konsiderohet reference qe perfshin dhe pasardhesit e pranuar.

1.3 Konfliktet

Ne kete Marreveshje (duke perfshire Kushtet paraprake dhe Anekset), perveç rasteve kur konteksti kerkon ndryshe ose kur eshte specifikuar ndryshe ne vazhdim:

- 1.3.1 Ne rastin kur dispozitat e cilitdo dokumenti transaksioni jane ne mosperputhje me kete Kontrate: (i) dispozitat e kesaj Kontrate do te kene perparesi, dhe (ii) asnje Pale nuk do te gezoje te drejta ne baze te dispozites qe eshte ne mosperputhje me Kontraten.
- 1.3.2 Ne momentin qe dispozitat e ndonje Aneksi apo shtojce te kesaj Kontrate jane ne mosperputhje me kete Kontrate: (i) dispozitat e kesaj Kontrate do te kene perparesi, dhe (ii) asnje Pale nuk do te gezoje te drejta ne baze te dispozites qe eshte ne mosperputhje me Kontraten.

2 OBJEKTI DHE QELLIMI I TRANSAKSIONIT

2.1 Shitja dhe Blerja e Aksioneve

Bazuar ne kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete Kontrate, ne Daten e Nenshkrimit, Shitesit do t'i shesin dhe transferojne Bleresit Aksionet ne Shitje te ABC NEWS sha dhe Bleresi do te bleje dhe perfitoje Aksionet ne Shitje te Abc News sha, per çmimin e percaktuar ne vlere e sipas kushteve te treguara ne nenin Nenin 3, ne perputhje me kushteve dhe modaliteteve te percaktuara ne Kontrate.

2.2 Koha e Kalimit te Pronesise mbi Aksionet ne Shitje te Abc News

Kalimi i pronesise mbi Aksionet ne Shitje te Abc News nga Shitesit te Bleresi do te regjistrohet ne regjistrat publike me pagimin e Cmimit te Aksioneve ne Shitje si tregohet ne nenin 3.2 me poshte. Ne cdo rast, Bleresi do te mbetet i detyruar te zbatoje kushtet e percaktuara ne kete kontrate dhe plotesoje detyrimet e parashikura shprehimisht ne kontrate deri ne shlyerjen e Detyrimeve te deklaruar ne kete kontrate.

2.3 Te drejtat e Bleresit dhe ose Shitesve nga momenti i nenshkrimit e deri ne momentin e shlyerjes se plote te Detyrimeve

2.3.1 Bleresi do te fitoje te drejtat e plota te pronesisë mbi aksionet ne shitje vetem pasi te plotesohen Detyrimet e marra persiper ne kete kontrate ne lidhje me Cmimin e aksioneve dhe Detyrimet e Deklaruara. Palet me marreveshje kane rene dakort qe Bleresi te regjistrohet ne regjistrat publike me pagesen e Cmimit te Aksioneve ne Shitje e te jete ai pergjegjes per te drejtat e detyrimet e Shoqerise ABC News qe prej dates se Dorezimit. Nderkohe, nga data e Dorezimit e deri ne daten shlyerjes se detyrimeve te marra persiper ne kete Kontrate, Bleresi do te kete te drejta e kufizura pronesisë e menaxhimi te Shoqerise te treguara ne Nenin 7 me poshte. Pas shlyerjes se detyrimeve te treguara ne nenin 3 dhe 9 te kesaj Kontrate, ne afatin e treguar ne to, Bleresi do te kete te drejta te plota e te pakufizura mbi aksionet ne shitje. Duke qene se Shoqeria ushtron aktivitet ne vijimsi, ka detyrime/te drejta te cilat i perkasin aktivitetit te shoqerise deri ne daten 31.7.2019 por maturohen, behen te kerkueshme, te pagueshme apo arketohen pas kesaj date. Ne lidhje me sa me siper, palet ne daten e dorezimit do te nenshkruajne nje procesverbal per faturat e leshuara dhe te paarketuara per shitje te mallrave apo sherbimeve nga ana e shoqerise "ABC News" sha deri ne date 31.7.2019 kundrejt detyrime te maturuara deri ne kete date por te pagueshme ne muajin Gusht 2019. Palet bien dakort qe te rakordojne keto vlera ne vijimsi cdo muaj dhe vlera e te ardhurave deri ne date 31.07.2019, pas zbritjes se shpenzimeve te deklaruar per furnitore deri ne kete date, do ti takojë Shitesit. Perjashtimisht, Dividenti i pjeseshem i llogaritur deri ne daten e dorezimit te Shoqerise do ti takojë Shitesit e do te paguhet nga Bleresi tek Shitesi ne momentin e shperndajes se dividendit ne perfundim te vitit fiskal 1.1.2019 deri ne 31.12.2019. Per te menjanuar cdo dyshim ne rast se shoqeria vendos te mos shperndaje dividend per vitin 2019 ajo do te zgjidhe me mirkuptim me Shitesin vleren e dividendit pjesor per vitin 2019.

3 ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

3.1 ÇMIMI I BLERJES

- 3.1.1 Pagesa totale per Aksionet ne shitje te ABC News do te jete EURO 600,000 (gjashteqind mije) Euro.
- 3.1.2 Çmimi i Blerjes nuk do te perfshije regjistrimin ose tarifat administrative per ndryshimin e titullit te pronesisë se aksioneve apo praktika te tjera administrative, qe do te mbulohen plotesisht nga Bleresi.

3.2 MENYRA E PAGESES PER ÇMIMIN E BLERJES

- 3.2.1 Çmimi i Blerjes ne masen EURO 600,000 (gjashte qind mije) do te paguhet ne 1 kest te vetem ne menyre proporcionale ne llogarite e secilit prej shitesve si me poshte:

Aksioneri Alba Gina

Numri i llogarise: Raiffeisen Bank

EUR 2000983339

IBAN AL 28202111820000002000983339

ABA Swift: SGSBALTX

Aksioneri Aleksander Frangaj

Numri i llogarise:

EUR 4500000364

IBAN AL06202112710000004500000364

ABA Swift SGSBALTX

3.2.2. Shuma prej 300,000 (treqind mije) euro do te paguhet ne llogarine e Aksionerit Alba Gina brenda 14 dite kalendarike nga Data e Dorezimit te Shoqerise, date e cila ne cdo rast eshte jo me vone se 1.8.2019.

Shuma prej 300,000 (treqind mije) euro do te paguhet ne llogarine e Aksionerit Aleksander Frangaj brenda 14 dite kalendarike nga Data e Dorezimit te Shoqerise, date e cila ne cdo rast eshte jo me vone se 1.8.2019.

4 DATA E NENSHKRIMIT DHE KUSHTET

4.1 NENSHKRIMI

4.1.1 Ne Daten e Nenshkrimit, secila Pale duhet te kete plotesuar gjithë kushteve per te cilat ishte pergjegjese, *inter alia*, per Nenet 4.2.2.

4.2 KUSHTET NE DATEN E NENSHKRIMIT DHE/OSE NE DATEN E DOREZIMIT

4.2.1 Ne Daten e Nenshkrimit, Shitesit do te:

1. nenshkruajne dhe te dorezojne tek Bleresi, ne çdo forme, çdo dokument tjetër që mund të kërkohej për regjistrimin e kalimit të Aksioneve në Shitje të Abc News nga Shitesit tek Bleresi kalim i cili do të kryhet në datën e kryerjes së pageses së kestit të parë e treguar në klauzolen 3.2. më lartë.
2. të nenshkruajne rregullisht kete Kontrate;
3. të pergatisin anekset të cilat i bashkelidhen kesaj kontrate, ne formen ne te cilen ato jane ne daten e nenshkrimit, duke marre persiper qe te ne cdo rast inventari dhe bilanci pjesor do te paraqiten sipas te dhenave te dates se nenshkrimit;

4.2.2 Ne Daten e Dorezimit Shitesit dhe Bleresit do te:

1. të sigurojne qe drejtoret/administratori e ABC News sha te treguar nga ana e Bleresit, te nenshkruaje dhe dorezojne ne regjistrat tregtare formularet e aplikimeve te plotesuar ne menyre te duhur dhe te gjitha dokumentet mbeshetese te nevojshme per regjistrimin e kalimit te titullit te pronesise se Aksioneve ne Shitje te ABC News sha nga Shitesit te Bleresi;
2. të sigurojne qe ne Daten e Dorezimit, drejtoret/administratori e ABC News sha, te nenshkruajne dhe dorezoje ne formen e kerkuar nga Bleresi doreheqjet nga detyrat e tyre funksionale pa implikuar kosto apo shpenzime shtese per palen Blerese.

5 KALIMI I SE DREJTES SE PRONESISE SE AKSIONEVE NE SHITJE

5.1 Me pagesen e Cmimit sipas nenit 3.2. me siper, Bleresi do te beje regjistrimin e te drejtes se pronesise se aksioneve ne shitje, Bleresi do te behet pronar i 100 % (njqind perqind) te

Aksioneve ne Shitje te Shoqerise ABC News sha dhe lejohet te ushtroje gjithë te drejtat qe rrjedhin nga pronesia mbi Aksionet ne Shitje, dhe Shitesi nuk do te kete pronesi, te drejta per dividend dhe/ose te drejte vote, dhe/ose ndonje te drejte ne menaxhimin e ABC te tjera vec ato te deklaruar si detyrime e te drejta te shoqerise ndaj Aksionereve deri ne daten e Dorezimit te shoqerise sipas kesaj kontrate, si dhe kufizimet e parashikuara shprehimisht ne kete Kontrate konkretisht ne Nenet 2.3.1 dhe 8.

5.2 Çdo dispozite e kesaj Kontrate dhe çdo Dokumenti Transaksioni, e cila eshte e mundur te kryhet me pas por nuk eshte kryer deri ne Daten e Dorezimit, duke perfshire te gjitha perfaqesimet dhe garancite ose detyrimet e paleve te permbajtura ose te ndermarra sipas kesaj Kontrate, do te mbeten ne fuqi te plote dhe do te kene efekt pavaresisht Nenshkrimit.

6 KUSHTET PARAPRAKE TE NENSHKRIMIT

Detyrimi i Bleresit per te blere aksionet ne shitje te ABC News sha dhe te paguaje Çmimin e Blerjes dhe detyrimi i Shitesve per te shitur dhe kaluar pronesine e Aksioneve ne Shitje te ABC news sha te Bleresi, kushtezohen nga permbushja ose heqja dore, ne ose deri ne Daten e Nenshkrimit te Kontrates, por jo me vone se Data e Nenshkrimit te kushteve paraprake te percaktuara ne nenet 6.1, 6.2 dhe 6.3 ("**Kushtet**") ne menyre te kenaqshme per Palet:

6.1 KUSHTET PARAPRAKE NEN PERGJEGJESINE E SHITESVE


Shitesit do te kryejne perpjekje te arsyeshme te sigurojne permbushjen e Kushteve si vijon:

- 6.1.1 Shitesit garantojne qe ABC News sha nuk asnje detyrim tjetër vec detyrimeve te deklaruar ne aneksin 4 dhe 5 si pjese te pasqyrave financiare, dhe garanton mbulimin e detyrimeve qe mund te lindin ne te ardhmen dhe qe i perkasin periudhes perpara Dates se Dorezimit te Shoqerise.
- 6.1.2 Te gjitha garancite e Shitesve do te jene te sakta dhe te verteta gjithë elementet materiale ne Daten e Nenshkrimit ose Dorezimit (nese ato jane te ndryshme), (pervec rasteve kur ngjarjet referohen nje date te caktuar ose per nje kohe te caktuar, e cila duhet te jete e vertete dhe e sakte vetem ne ate periudhe specifike kohore).

6.2 KUSHTET PARAPRAKE NE PERGJEGJESINE E BLERESIT

Bleresi do te kryejte perpjekje te arsyeshme te siguroje permbushjen e Kushteve si vijon:

- 6.2.1 Te marre te gjitha autorizimet, miratimet, urdhrat ose aprovimet, depozitimet (nese ka), per te realizuar blerjen e Aksioneve e ne shitje te ABC news sha.
- 6.2.2 Te gjitha garancite e Bleresit do te jene te sakta dhe te verteta ne çdo aspekt material ne Daten e Nenshkrimit/Dorezimit.
- 6.2.3 Bleresi ka paraqitur prove qe ka fonde per te paguar Çmimin e Blerjes dhe detyrimet e pranuar te shoqerise ndaj te treteve te marra pesiper prej tij. Bleresi deklaroi dhe garanton se fondet ne dispozicion per pagimin e Çmimit te Blerjes jane nga burime te ligjshme.



7 DEKLARATAT DHE GARANCITE

7.1 DEKLARATAT DHE GARANCITE E BLERESIT

Bleresi ben deklarata dhe garancite e meposhtme per Shitesit ne lidhje me veten e tij, ku secila prej tyre eshte e vertete, e sakte dhe jo çorientuese ne Daten e Nenshkrimimit dhe duhet qe te jene te verteta, te perpikta dhe te sakta ne Daten e Nenshkrimimit.

7.1.1 Organizimi

Bleresi eshte nje shoqeri e qe zhvillon aktivitet tregtar rregullisht dhe eshte e organizuar rregullisht, themeluar ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise nuk eshte ne gjendje paaftesie paguese si dhe ka te drejta te plota per te kryer aktivitetin e saj tregtar siç eshte organizuar.

7.1.2 Autorizime

Te gjitha aktet e shoqerise dhe/ose veprimet e tjera qe kerkohet te merren nga ose ne emer te Bleresit per te autorizuar ate per te hyre dhe per te zbatuar kete Kontrate dhe Dokumentet e Transaksionit qe Palet jane marre dhe jane te vlefshme, kjo Kontrate eshte nenshkruar rregullisht dhe eshte dorezuar nga Bleresi dhe perben nje detyrim te vlefshem te Bleresit ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne te.

7.1.3 Raporti i pasqyrave financiare dhe te drejtave e detyrimeve

Bleresi deklaron qe ka paraqitur oferten e tij financiare per cmimin e blerjes mbi bazen e pasqyrave financiare dhe bilanceve publike te shoqerise te cilat jane paraqitur nga Shitesit, por dhe nga njohurite e pergjithshme qe Bleresi ka pasur per biznesin e ABC news sha. Ne percaktimin e cmimit Bleresi ka marre ne konsiderate edhe detyrimet qe shoqeria ka ndaj paleve te treta dhe qe jane te pasqyrura ne pasqyrat financiare dhe konkretisht: detyrime ndaj aksionereve ne mase 609,600 euro, detyrime per blerje pajisjesh ne masen 240,000 euro (perfshire TVSH), dhe detyrime te prapambetura per qera te shoqerise ABC news sha ne vleren 296,282 euro dhe detyrime te parapagim per qera ambientesh (1.8.2019 – 31.7.2021)ne vleren 294,118 Euro.

7.1.4 Fondet

Bleresi do te kete ne Daten e kryrjes se pageses sipas nenin 3 te kontrates fondet e disponueshme ne mjete likuide qe jane te kerkuara per pagimin Çmimit te Blerjes dhe te detyrimeve qe shoqeria ka tek te tretet ne masen e treguar ne pasqyrat financiare te treguara ne anekset 4 dhe 5 te kesaj kontrate.

7.1.5 Vazhdimesia e Biznesit te ABC News sha

Nga momenti i marrjes ne Dorezim te Shoqerise e deri sa te paguhet vlere e Detyrimeve te percaktuara ne nenin 1, Bleresi nuk do te kete te drejta te plota menaxhmi te shoqerise e konkretisht ai nuk do te ndryshoje strukturen programore te emisioneve televizive dhe ose nuk do te kryeje veprime te tjera te cilat te mund te cojne ne rritjen e detyrimeve te shoqerise ABC NEWS sha pa mare me pare miratimn paraprak te Shitesve, miratim i cili nuk do te pengohet pa shkaqe te justifikuara. Me pagesen e Cmimit te plote te Blerjes dhe shlyerjen e Detyrimeve te percaktuara ne neni 1, Bleresi do te kete liri te plote per te marre cdo vendim ne lidhje me shoqerine dhe aktivitetin e tij te biznesit. Gjate kesaj periudhe, Bleresi dhe shoqeria ABC News sha nuk do te marre persipet detyrime

pavaresisht nga vlera, pa miratimin e shprehur me shkrim te Shitesve. Parashikimet e ketij neni dhe nenit 2 interpretohen ne harmoni me njeri – tjetrin.

7.1.6 Transferimi i aksioneve te te tretet

Deri ne pagesen e plote te Cmimit dhe pageses se Detyrimeve sipas kesaj Kontrate, Bleresi nuk do te kete te drejte transferoje tek ndonje pale e trete, qofte edhe pjeserisht Aksionet ne shitje te ABC News Sha pa miratimin paraprak te shprehur me shkrim te Shitesave, si dhe nuk do te marre persiper detyrime ndaj te treteve me ndonje pjese te asteteve te Shoqerise ABC News sha,

7.2 DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESVE

Shitesit deklarojne dhe garantojne qe deklarimet dhe çeshtjet te percaktuara ne nenet 7.2.1 (*Organizmi*) deri dhe perfshire nenin 7.2.12 (*Taksat*) jane te verteta, te sakta dhe skane ndonje qellim per te corientuar Bleresin.

7.2.1 Organizimi

ABC NEWS SHA eshte nje shoqeri ekzistuese e vlefshme, e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe nuk eshte ne gjendje paaftesie paguese apo falimentimi, nuk eshte subjekt i ndonje paaftesie paguese, likuidimi apo ne procedura prishjeje dhe ka kompetencen dhe autoritetin e plote per te menaxhuar aktivitetin e shoqerise dhe pronat e saj. ABC NEWS SHA eshte pajisur me te gjitha licencat, lejet, autorizimet thelbesore dhe pelqimet e kerkuara per kryerjen e aktivitetit te shoqerise. ABC NEWS SHA operon ne perputhje me ligjet e zbatueshme, me gjykimet, dekrete e çdo gjykate, komisioni apo çdo Autoriteti Shteteror.

7.2.2 Autoriteti per te hyre ne kete Kontrate

Shitesit kane pushtetin dhe autoritetin e plote per te zbatuar Kontraten dhe Dokumentet e Transaksionit ne te cilen ata jane pale. Kjo kontrate do te komunikohet prane Autoriteti te Mediave Audiovizuale dhe do ti njoftohet Autoritetit te Konkurences. Palet do te bashkepunojne per te bere te mundur finalizimin e ketyre praktikave administrative ne kohe e pa vonese. Ne cdo rast kerkesa per njoftimin do paraqitet brenda 2 dite pune nga regjistrimi i kontrates ne QKB, dhe Bleresi duhet te paraqese te dokumentat e nevojshem brenda ketij afati. Lista e dokumentave i bashkelidhet kesaj kontrate si shtojca nr.1.

7.2.3 Pronesia

- Shitesit jane pronaret e vetem, ligjore dhe perfitues te Aksioneve ne Shitje te ABC News sha. Abc News sha zhvillon aktivitet tregtar sipas objektit te aktivitetit te shoqerise dhe konkretisht eshte pronare e televizionit, radios dhe faqes se web Abc News sh.a., aktivitete tregtare te cilat per te menjanuar cdo lloj dyshimi, jane te shoqerise ABC News sha e do te mbeten te saj edhe pasi transferimit te aksioneve nga Shitesit te Bleresit. Po keshtu ne pronesi te shoqerise do te mbetet edhe arkiva e programeve dhe/ose emisioneve te prodhuara apo transmetuar ne televizion apo radio ne perputhje

me marrevshjet per pronesine intelektuale qe jane ne fuqi ne ditën e nenshkrimit te Kontrates.

- Aksionet ne Shitje jane aksione te zakonshme, dhe paguar plotesisht dhe te lira nga cdo lloj barre dhe detyrimi apo ndalimi transferimi.

7.2.4 Pasqyrat financiare dhe Bilancet e shoqerise

Pasqyrat financiare pasqyrojne teresine e situates financiare te shoqerise dhe detyrimet e percaktuara ne te si dhe shpenzimet mesatare mujore jane ato te treguara ne pasqyrat financiare.

7.2.5 Kontrata

- Kopjet e çdo kontrate, dokumenti ose prova te tjera materiale qe permban ndryshe afatet dhe kushtet e ndonje kontrate materiale ose te drejta thelbesore ose detyrime te Abc News sha jane te perfshira ne Informacionin e Dhene.
- Nuk ka asnje shkelje, pavlefshmeri, ose arsye per heqjen dore, shmangien ose hedhje poshte te kontratave qe Abc News eshte pale (perfshi çdo furnizues ose kontrate konsumatorësh) ose çdo pretendim te ketij fakti qe te jete thelbesor per Biznesin e Targetit.

7.2.6 Transaksionet me Palet e Lidhura


Perveç Dokumenteve te Transaksionit, ne Daten e Nenshkrimit:

- Abc News sha nuk eshte pale si dhe nuk ka bere asnje kontrate, Kontrate, angazhim, premtim ose çdo lloj tjetër ndermarrje me pjesetaret e grupit te Shitesit;
- Nuk ka asnje kontrate, angazhim, garanci ose demshperblime tek te cilat Abc News sha eshte pale dhe ne te cilen ndonje pjesetar i grupit te shitesit eshte direkt ose indirekt i interesuar; dhe
- Asnje nga shitesit, ndonje prej drejtoreve ose punemarresit e tyre (ish drejtoret ose ish punemarresit) nuk kane ndonje kerkese ose pretendim apo kane ndermarre ndonje veprim kundrejt ABC News sha (aktuale, te pritshem apo te mundshem).

7.2.7 Punesimi

- Numri i plote, i sakte dhe i vertete i te gjithë punemarresve me kontata punesimi te vlefshme me ABC news sha (kolektivisht "Punemarresit" dhe individualisht nje "Punemarres") ne Daten e Nenshkrimit, ku tregohet pershkrimi i punes dhe periudha e njoftimit, eshte specifikuar ne Informacionin e Dhene. Gjithashtu ne Informacionin e Dhene perfshihen te dhenat per pagën dhe shperblime te tjera te çdo Punemarresi. Detyrimet e Bleresit per pagesat e personelit, si dhe cdo detyrim tjetër per zhvillimin e aktiviteti) do te lindin nga momenti i Dorezimit te Shoqerise ne datën 01.08.2019, pavaresisht miratimit te transaksionit prej autoritetve te treguara ne piken 7.2.2 me sipër.
- Punemarresit jane punesuar ekskluzivisht sipas kushteve te Kontrates te tyre respektive te punesimit.
- Abc News sha nuk ka qene pale ose lidhur me asnje marrevshje kolektive pune. Nuk ka asnje problem ekzistues apo te meparshme ne lidhje me stafin.

7.2.8 Asetet



- Ne Daten e Nenshkrimitt, titujt e ABC NEWS SHA mbi pasurite jane efektive dhe te pa kundershuar.
- Abc News sha ka titull pronesia te vlefshme dhe te padiskutueshme dhe eshte i vetmi pronar perfitues ligjor i stokut, mobileve, instalimeve, pajisjeve, dhe automjeteve.
- Ne Daten e Nenshkrimitt, te drejtat e shoqerise mbi listen e inventarit jane efektive dhe te pa kundershuar. Nuk jane te reregjistruara barre te asnje lloji mbi asetet.
- Shitesit garantojne se ABC News nuk zoteron pronesi intelektuale te reregjistruar dhe nuk cenon asnje pronesi intelektuale te zoteruara ose te mbajtura nga persona te trete.
- Ndonje ndryshim ndermjet inventarit fizik dhe vlerave kontabel nuk do te konsiderohet si kosto e berjes biznes dhe asnje pergjegjesi nuk do ti ku drejtohet Shitesve.

7.2.9 Ceshtjet gjyqesore

ABC news sha nuk eshte perfshire ne ndonje ceshtje gjyqesore, arbitrazhi, apo ne procese te tjera te zgjidhjes se mosmarreshjeve, ose ne procedura penale dhe administrative, qofte si padites, i paditur ose ndryshe, pervecse ceshtjes qe eshte paraqitur ne infomacionin e dhene. Shitesi garanton se nuk ka asnje ceshtje gjyqesore, arbitrazhi, apo procese te tjera te zgjidhjes se mosmarreshjeve ose veprime, ose procedura penale, tregtare dhe administrative kundrejt ABC NEWS SHA, te meparshme apo qe priten te ndodhin. Cdo detyrim qe mund te linde ndaj Shoqerise ne lidhje me aktivitetin e saj para dates se dorezimit do te jete pergjegjesi e saj sipas parashikimeve te nenit 8 me poshte.

7.2.10 Taksat

- Abc News sha ka dorezuar ne menyre te rregullt te gjitha deklaratat tatimore dhe ka dorezuar te gjitha informacionin perkates tek Autoriteti Tatimor i zbatueshem siç kerkohej nga Ligjet Tatimore te zbatueshme.
- Abc News sha ka pergatitur dhe ruajtur te gjitha te dhenat dhe regjistrimet dhe dokumentet e kerkuara sipas Ligjeve Tatimore dhe ka ne posedim keto dokumente.
- Abc News sha ka paguar te gjitha taksat, deri ne Daten e Dorezimit, te cilat jane bere te detyrueshme per tu paguar dhe nuk ka qene i njoftuar per ndonje detyrim per te paguar ndeshkime, interesa, shtesa, gjoba, shtesa te parazgjedhura ose pagesa te tjera ne lidhje me ndonje kerkese per taksat.
